



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e X-të (dhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 28 prill 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10:40.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Demokrat Hodolli, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, dhe znj.Naile Ahmeti,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Bahri Selimi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, z.Skender Shatri dhe z.Bekim Karaxhija nga OSBE, z.Zolta Gezho dhe z.Laslo Olah, përfaqësues të KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim.

Paraprakisht përshëndetje të veçantë kam për përfaqësuesit e KFOR dhe OSBE për prezencën e tyre në këtë mbledhje.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 22.03.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 22 mars 2023

2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, lidhur me projektet që ndërlidhen me komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës, si dhe shqyrtimi i mundësive që ndërlidhen me realizimin e tyre.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ka qenë e planifikuar të raportoj Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe për këtë bisedova me drejtorin nga i cili u njoftova se do të merr pjesë në këtë mbledhje por ende nuk është prezent dhe arsyet nuk di përse.

Shefi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK z.Liman Zeqiri i ka të gjitha të dhënat lidhur me këtë çështje sepse ne bashkërisht edhe me koordinatorin e Njesisë për të Drejtat e Njeriut-KNDNJ z.Ahmet Ahmetin kemi dalë në terren dhe kemi vizituar familjet e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Lagjen e rrugës “Ali Ajeti” dhe prioritet për ato familje në këtë rrugë/lagje është rregullimi i gypit të ujit ngase aktualisht gypi është azbest dhe ka një kohë të gjatë që është vendosur, madje mund të themi se edhe është kalbur ngase ka qenë në vizitë një Organizatë e cila ka bërë analizat e ujit dhe ka dal me konstatim se është jo i pijshëm duke dhënë edhe disa vërejtje konkrete, kështu që ka nevojë ajo pjesë për një rrjet të ri të ujësjes, kërkesa përkatëse është bërë disa herë në Komunë dhe pritet të realizohet si projekt, por sa kohë bënë nuk e di, përndryshe z.Liman Zeqiri i ka të gjitha informatat.

Çështja e dytë ka të bëjë me kërkesën për ndërtimin e disa shtëpive për familjet e komuniteteve jo shumicë ku shumica prej tyre kanë konkurruar në projektin përkatës që është enkas për komunitete në kuadër të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, mirëpo përgjigja e drejtorit përkatës në atë Ministri ishte dhënë haptas se shumicën e mjeteve financiare nga ky projekt do ta dërgoj për komunitetin që i përket ai (komunitetin serb), kurse sipas tij, ato mjete që mbesin në këtë projekt do t’jua japim juve, ndërsa sa do të ketë sukses në këtë drejtim nuk mund ta di tani edhe pse një numër i madh kanë konkurruar në atë projekt që është për ndërtimin e shtëpive të komuniteteve jo shumicë.

Po ashtu disa projekte që i kemi paraparë dhe vlerësuar me shefin e ZKKK janë disa shtëpi që kanë nevojë për renovimin e tyre ngase ka shtëpi që nuk janë të përfunduara, pastaj ka shtëpi të dëmtuara nga shiu dhe fenomene tjera të ngjashme e të cilat rrezikohen edhe të vet rrenohen, pra këto janë ato që ne i kemi paraparë.

Mandej kemi rrugicën tjetër në rrugën/lagjen “Ali Ajeti” kemi një çështje ku nuk sipas informatave që kam në projektin e rrugës që është bërë tani dhe shtrirjes së rrjetit të energjisë ka qenë i planifikuar edhe ndriçimi publik por që nuk është realizuar, pra nuk janë vendosur shtyllat për ndriçim publik e që ka nevojë të madhe për ndriçimin e asaj rruge sepse tani veç po jemi në dijeni të gjithë për disa gjëra dhe dukuri negative që po ndodhin, si dhe kërkesë tjetër në këtë rrugë është që të vazhdohet sepse ka mbete rreth 50-60 metra pa u asfaltuar, kështu që mund të vazhdohet të shtrohet edhe në kubëza.

Pra është mirë që shefi i ZKKK së bashku me drejtorin e DSHPMSh t’i bëjnë këto projekte dhe t’i nisin procedurat për realizimin e tyre sepse janë shumë të nevojshme tani për tani.

Tani meqë drejtori i Drejtorisë përkatëse është prezent në mbledhje, mund ta merr fjalën dhe të na informoj më në detaje lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, duke paraqitur informatën në fjalë, fillimisht kërkoj falje për vonesën, ndër të tjera theksoi, nuk po e di sakt se çfarë u diskutua deri tani dhe për cilat projekte bëhej fjalë sipas kësaj pike të rendit të ditës që është caktuar nga ana juaj, mirëpo po ju informoj për disa projekte të cilat janë realizuar deri tani edhe pse thënë të drejtën nuk është që DSHPMSh dhe Komuna e Podujevës në përgjithësi bënë projekte të ndara apo të veçanta qoftë

për komunitetet jo shumicë qoftë për shumicë por mundohemi që në të gjitha projektet të përfshihen të gjitha komunitetet apo thënë më mirë të gjithë qytetarët pa dallime ngase në rast se bëhen projekte të veçanta vetëm për komunitete unë nuk e shoh shumë të drejtë por më shumë do ta shoh si diskriminim në një mënyrë ngase nuk mund dhe nuk duhet të bëjmë ndasi kur të gjithë jetojmë bashkërisht në një Komunë dhe që të gjitha projektet janë të përbashkëta.

Tani po ju informoj me disa projekte të cilat kanë prekur edhe familjet e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në lagje dhe rrugë të ndryshme të Komunës së Podujevës edhe pse në një mënyrë të gjithë jemi në dijeni për gjendjen qoftë infrastrukturore qoftë të përgjithshme të Komunës së Podujevës që ende vërtetë ka mungesë të infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, të ujësjellësit dhe të ngjashme.

Si projekt i cili mund të themi se ka qenë paksa më i veçantë për komunitetin jo shumicë ka qenë projekti i rrjetit të kanalizimit në fshatin Orllan i cili paksa ka qenë i stërzgatur mund të them, pra është bërë për lagjen në afërsi të liqenit, projekt i cili ende mbetet i papërfunduar dhe për këtë arsye e cilësova si të stërzgatur por që tani ato familje që jetojnë aty nuk kanë probleme me kanalizim por që problemi mund të cilësohet paksa më i madh sepse ende nuk ka përfunduar projekti i rrjetit të përgjithshëm të kanalizimit e që kjo po na paraqet një problem ngase ujërat e zeza të asaj lagjeje fatkeqësisht pjesa më e madhe e tyre derdhen në liqen, problem ky të cilin e kemi trajtuar goxha gjatë, kemi pas takime të shpeshta me kompaninë apo organizatën CDI që e ka këtë projekt por që e cila punimet i ka lënë në gjysmë dhe sot e saj dite nuk e di se si do ta përmbyllim atë projekt me atë organizatë e cila është e ndërkombëtare dhe ta marrim në dorë ne kompetencën dhe përgjegjësinë në mënyrë që ta bëjmë rregullimin e këtij projekti i cili realisht nuk është projekt që prek vetëm Komunën e Podujevës por përfshinë edhe Ministrinë Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës. Pra edhe pse komuniteti në atë lagje nuk kanë probleme tani sepse janë të kyçur në kanalizim, mirëpo problemi qëndron sepse ujërat e zeza nuk derdhen aty ku është planifikuar me projekt dhe me plan.

Po ashtu në fshatin Orllan kemi pas një kërkesë të komuniteteve jo shumicë për trajtimin e një rruge me kubëza, kërkesë të cilën e kemi trajtuar me seriozitet dhe me prioritet dhe ajo rrugë vitin që lam pas është përfunduar.

Sa i përket familjeve të komuniteteve jo shumicë që jetojnë si lagje në rrugën “Xhafer Meta”, është lagje e cila preket nga projekti i rrugës së re “Skënderbeu” e cila është duke u rregulluar sepse një pjesë dermuese e komunitetit jo shumicë jetojnë në atë lagje e që mund të paraqiten probleme eventuale sepse rruga ende është duke u ndërtuar, parashihet edhe ndriçimi publik në atë rrugë që do të jetë një prej ndriçimeve moderne të kohës, pastaj do të ketë trotuare me një gjerësi të mjaftueshme në mënyrë që të mos rrezikohen banorët dhe qytetarët që lëvizin andej, por që si punë shtesë përtej asaj që ka qenë do të jetë edhe shtegu i biçiklistëve në të dyja anët e rrugës që do të ndihmoj dhe lehtësoj goxha shumë lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Kemi pas goxha shumë edhe kërkesa për mirëmbajtjen e infrastrukturës duke përfshirë edhe kanalizimet sepse tani jemi në dijeni se kanalizimet janë paksa të vjetruara dhe në ato vende ku nuk është bërë ndërrimi i gypave ka shumë nevojë për ndërhyrje dhe mirëmbajtje, madje për kuriozitet sot e pata një kërkesë për hapjen e kanalizimit në lagjen që është në rrugën “Xhafer Meta” sepse ishte bllokuar por që e dërguam kompaninë përkatëse që të ndërhyjë në hapjen e saj. Jemi munduar t’iu përgjigjem me një përgjegjësi dhe seriozitet, dhe atë jo vetëm kërkesave të komuniteteve jo shumicë por ndaj të gjithave, por ato të komuniteteve për një nuancë i kemi trajtuar paksa më veçantë ngase kërkesat e komuniteteve jo shumicë nuk kanë qenë edhe aq të mëdha e që eventualisht do të na ndërronin projekte tjera.

Sa i përket planifikimeve që ne kemi bërë për të ardhmen e afërt në lidhje me kërkesat e komuniteteve dhe për këtë çështje kemi pas një takim edhe me Ministrin e Ministrisë së Pushtetit Lokal z.Elbert Krasniqi me të cilin jemi dakorduar që ne ta bëjmë një kërkesë me projekte të caktuara për kërkesat e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Komunën tonë dhe një gjë të tillë jemi duke e bërë dhe fatmirësisht ministri në fjalë ka shpreh gatishmëri ta ndihmoj Komunën e Podujevës sa i përket kërkesave dhe projekteve të komuniteteve jo shumicë.

Para rreth dy ditëve në Ministrinë e cekur është hap thirrja publike për t'i dërguar projektet dhe ne bashkërisht me ju do t'i dërgojmë të gjitha kërkesat që parashihen si të nevojshme e që kjo Ministri do ta merr përsipër që t'i realizoj e që procedurat e prokurimit do t'i udhëheqim ne kurse realizimi do të bëhet bashkërisht.

Kemi planifikuar edhe një trotuar në fshatin Batllavë ku jetojnë komunitetet jo shumicë dhe që përfshihet e gjithë lagjia ku jetojnë ky komunitet dhe që lidhet me rrugën kryesore dhe vazhdon deri te shkolla përkatëse ku ata ndjekin mësimet.

Përveç këtyre ka edhe kërkesa të ndryshme siç janë më të theksuara që janë për mirëmbajtje të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe besoj se në këtë vit do ta bëjmë një projekt të përbashkët dhe besoj se do t'i kryejmë të gjitha kërkesat e paraqitura nga komunitetet jo shumicë.

Gjithashtu ju informoj se me Ministrinë përkatëse kemi diskutuar edhe në lidhje me sigurimin e vendbanimeve dhe në këtë aspekt na është dhënë një propozim i cili nuk na ka pëlqyer ngase ka qenë ndërtimi i një objekti për familjet e komuniteteve jo shumicë e që ne nuk jemi pajtuar me këtë sepse nuk kemi dashur të bëjmë getoizimin e asnjë komuniteti që jeton në Komunën tonë, mirëpo sigurisht se do të bëjmë mirëmbajtjen dhe renovimin e shtëpive aty ku është e nevojshme, edhe pse për këtë që e potencova është vetëm sa për informimin e juaj sepse ende nuk ka ndonjë zyrtarizim në këtë aspekt por shpresojmë shumë se do ta shtyjmë përpara këtë proces dhe nëse arrijmë që të dakordohemi për një projekt të tillë me Ministrinë kjo i bie që edhe çështjen e banimit të familjeve të komuniteteve jo shumicë që është paksa problematike dhe që ka nevojë, do ta zgjidhim dhe do të ketë një jetë më komode.

Pra kjo ishte sa për fillim mirëpo nëse ndokush ka diçka rreth kësaj teme urdhëroni unë jam i hapur t'ju jap përgjigje, sqarime apo informata përkatëse.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj drejtorin për informata e dhëna.

Unë kam një kërkesë e cila është bërë edhe më parë dhe për këtë ka pas analiza të ndryshme dhe madje ka qenë edhe vetë Ministri i Ministrisë përkatëse për të parë gjendjen nga afër, fjala është për lagjen ku jetojnë familjet e komuniteteve jo shumicë në rrugën "Ali Aleti" dhe ka të bëjë me ujësjellësin dhe gypin e vendosur shumë vite më parë që është azbest, gyp i cili është kalbur dhe uji nuk pihet. Për këtë çështje njëherë ka qenë një projekt dhe jam i njoftuar nga shefi i ZKKK z.Liman Zeqiri se ky projekt është dërguar për realizim, mirëpo ende asgjë, kështu që ky projekt mund të them se është më i rëndësishmi tani për tani për komunitetet jo shumicë, pra ai gyp duhet të ndërrohet në mënyrë që t'iu mundësohet asaj lagjeje të kenë ujë të pijes nga rrjeti i ujësjellësit ngase shumica e lagjes vazhdojnë ta blejnë ujin e pijes, prandaj edhe njëherë po ceku se prioritet kryesor për projektet e komuniteteve është ky që e ceka.

Po ashtu prioritet për komunitetet është edhe ndërtimi i disa shtëpive sepse vërtetë janë disa familje të cilat jetojnë në gjendje jo të mirë, madje ka rast ku 3 familje (3 vëllezër) jetojnë në 2 dhoma sepse nuk kanë ku të jetojnë, kështu që edhe me z.Liman Zeqiri shef i ZKKK kemi paraparë që familjet që janë më shumë në nevojë të aplikojnë në projektet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim që tani së fundmi është hapur edhe konkursi për aplikim për ndërtimin e shtëpive dhe sipas informatave që kam është një numër i madh që ka aplikuar dhe besoj se do të kërkohet edhe nga Ju (Komuna e Podujevës) mendim lidhur me kërkesat e paraqitura për

ndërtimin e shtëpive të banimit dhe për renovim të shtëpive për familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën tonë.

Mund t'ju informoj vetëm për një rast që kemi hasë gjatë vizitave që kemi bërë me shefin e ZKKK ku kemi parë se as dritare nuk kishte një familje por vetëm me perde kishte mbuluar dritaren, kështu që ka nevojë për ndërhyrje sa i përket banimit të komuniteteve jo shumicë.

Pastaj në rrugicën tjetër në atë Lagje, janë shtrirë gypat e rrjetit të ndriçimit, janë heqë shtyllat e ndriçimit publik dhe më asnjë lëvizje nuk ka ndodhë në këtë aspekt, rruga ka mbete ashtu pa ndriçim si dhe në të njëjtën rrugë kanë mbetur rreth 50 m pa asfaltuar për shkak të mosmarrëveshjeve mes fqinjëve, tani është arritur një marrëveshje për rregullimin edhe të asaj pjese të rrugës, kështu që kërkesa është që të vazhdohet ajo rrugë me asfalt ose në kubëza.

Pra në bazë të vizitave që kemi pasë në lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë, të gjitha informatat dhe shënimet i posedon z.Liman Zeqiri shef i ZKKK me të cilin sot nga ora 14:00 kemi një takim dhe do të kërkoj që të gjitha ato të dhëna dhe ato kërkesa t'ju përcjellën edhe juve si Drejtori.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSSH, theksoi, lidhur me këto që u ceken nga parafolësi, dëshiroj të jap disa sqarime dhe informata të nevojshme.

Për rrjetin e ujësjellësit, konkretisht për gypin e ujit të pijes në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në rrugën "Ali Ajeti" jemi të njoftuar dhe është problem i mëhershëm, tani Komuna nuk ta drejtë të bëjë zgjerim dhe as mirëmbajtje të rrjetit të ujësjellësit sepse kjo çështje nga viti i kaluar ka kaluar komplet në kompetencë të Ndërmarrjes KRU "Prishtina" dhe ne as nuk kemi buxhet e as projekt sepse buxheti për çështje të tilla është bartur komplet tek Ndërmarrja e cekur, mirëpo për këtë kemi biseduar me shefin e ZKKK si dhe me banorët e asaj lagjeje dhe kemi vendosur që këtë kërkesë si projekt ta përfshijmë në kuadër të kërkesave që do t'ia adresojmë Ministrisë përkatëse e që kjo Ministri ka buxhet dhe besojmë se do të ndaj një pjesë të buxhetit për këtë projekt e që shpresoj shumë se do të bëjmë atë kërkohe.

Ndërsa sa i përket ndërtimit të shtëpive për familjet e komuniteteve jo shumicë, ashtu siç u cek nga parafolësi, Ministria e cekur ka shpallë thirrje publike për aplikim për ndërtimin e shtëpive për komunitetet jo shumicë që jetojnë në tërë Kosovën, nuk e di sa do të jetë numri i përfituesve në këtë shpallje e që ne dëshirojmë që numri i përfituesve të Komunës së Podujevës të jetë sa më i madh edhe pse kemi të bëjmë për tërë Komunën, por sado që përfitojnë nga Komuna jonë sërish numri i tyre është i vogël, ndërsa kur fola më herët për këtë çështje fjala ishte për një diskutim të veçantë që kemi diskutuar me një Ministrin tjetër rreth kësaj çështje.

Sa i përket çështjes së ndriçimit publik në lagjen e cekur, e kam pranuar edhe si kërkesë dhe besoj që shumë shpejt do ta rregullojmë këtë çështje, por edhe atë rrugën që ka mbet në gjysmë do ta përfundojmë shpejt sepse nuk ndonjë problem i madh kjo edhe pse nëse ndokush nuk i ka informacionet e sakta rreth ndonjë rruge apo ndonjë rrjeti të ndriçimit publik mundeni lirshëm të vini në zyrën time dhe jua jap të gjitha informacionet e nevojshme.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe njëherë falënderoj drejtorin parafolës për të gjitha informatat dhe sqarimet e nevojshme rreth projekteve dhe kërkesave të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsiderojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderojmë Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK dhe shefin e saj z.Liman Zeqiri me të cilin bashkërisht kemi bërë kërkesë për ndihmë me pako ushqimore për familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës. Kërkesa është bërë për 175 pako të tilla në Organizatën Joqeveritare “Amaneti” edhe pse unë personalisht e kam një OJQ mirëpo ajo Organizatë nuk ka dashur të bashkëpunoj vetëm me mua pa u përfshirë edhe ZKKK e Komunës së Podujevës si Institucion, kështu që unë në emër të OJQ-së time e kam marrë pëlqimin nga ZKKK, është vulosur formulari dhe kemi marrë përkrahje me 50 pako ushqimore për familjet në nevojë nga komunitetet jo shumicë, pako të cilat janë shpërndarë në lagje dhe vende të caktuara ku jetojnë familje të komuniteteve jo shumicë, dhe atë në ato që kanë më shumë nevojë sepse në të gjitha nuk kemi mund të shpërndajmë ngase jemi përkrahur me vetëm 50 pako dhe ka qenë e pamundur të ndihmohen të gjitha familjet.

Pra kjo ishte vetëm sa për njoftim për anëtarët e këtij Komiteti dhe jo vetëm.

Gjithashtu falënderoj edhe përfaqësuesit e KFOR të cilët më kanë informuar për procesin e regjistrimit pa pagesë të fëmijëve të cilët eventualisht kanë mund të mos jenë të regjistruar me dokumentacion, mirëpo fati i mirë i joni është që në Komunën e Podujevës nuk fëmijë që ka lindur dhe nuk është regjistruar ngase kemi punuar me kohë në mënyrë që ata që lindin të mund të regjistrohen menjëherë në organet përkatëse, pra komuniteti jo shumicë është vetëdijësuar dhe këtë çështje e kryejnë me kohë, por megjithatë falënderoj KFOR-in për këtë lajmërim.

Gjithashtu falënderoj edhe OSBE-në për interesimin e tyre sa i përket braktisjes së shkollimit së nxënësve të komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës. Unë personalisht numrin e tyre nuk e di sepse tani nuk kam mediatorë përkundër që një kohë të mëparshme kam pasuar mediatorë dhe kam qenë i informuar në çdo kohë, mirëpo tani po më duhet të shkoj vet nëpër shkolla dhe të marr shënime dhe informata rreth këtyre çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë, kështu që mund të them se në vitet e mëhershme Komuna e Podujevës ka qenë e para në nivel Kosove sa i përket çështjeve në Arsim dhe këtë e them duke marrë parasysh se kam qenë mediatorë, mirëpo tani sipas informatave më duket se ka filluar braktisja e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve jo shumicë.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

**Nr.prot.02-060/04-0029844/23
Podujevë, 28 prill 2023**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**